



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

**Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police**

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore  
Direktorat za Strateško Planiranje i Zakonska Pitanja/Directorate for Strategic Planning and Legal Issue  
Sektori për Planifikim Strategjik / Sektor za Strateško Planiranje / Sector for Strategic Planning



# RAPORTI VJETOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2022



- Titulli i raportit: **Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës  
Janar - Dhjetor 2022**
- Përpiluesi: **Toger Fahrije LUTFIU**  
Sektori për Planifikim Strategjik, Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
- Mbikëqyrur: **Major Sadik SHEFQETI**  
Zëvendësshef i Sektorit për Planifikim Strategjik, Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
- Aprovon: **Kolonel Riza SHILLOVA**  
Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
- z. Dejan JANKOVIĆ**  
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë për Resurse
- Autorizon: **z. Fehmi HOTI**  
Ushtrues i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës
- Lektor: **znj. Leonora FEJZULLAHU - RUHANI**  
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun -  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- Përkthim në gjuhën angleze dhe serbe: **Sektori i përkthimeve**  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- Dizajni grafik: **z. Çajup KAJTAZI**  
Webdizajner  
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

**Policia e Republikës së Kosovës**  
[www.kosovopolicice.com](http://www.kosovopolicice.com)

☎ 192

✉ [info@kosovopolicice.com](mailto:info@kosovopolicice.com)

POLICIA E KOSOVËS

# TABELA E PËRMBAJTJES



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs  
**Policia e Kosovës/Policia Kosova/Kosovo Police**  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate  
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore  
Direktorat za Strateško Planiranje i Zakonska Pitanja/Directorate for Strategic Planning and Legal Issue  
Sektori për Planifikim Strategjik / Sektor za Strateško Planiranje / Sector for Strategic Planning



## RAPORTI VJETOR I PUNËS SË POLICISË SË KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2022



[www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)  
[www.facebook.com/KosovoPolice](https://www.facebook.com/KosovoPolice)  
[twitter.com/Kosovo\\_Police](https://twitter.com/Kosovo_Police)  
[info@kosovopolice.com](mailto:info@kosovopolice.com)  
Aplikacioni lajmëro Policinë  
192 ose 038 550 999

4

**Lista e shkurtesave**

5

**Mesazhi i drejtorit të Përgjithshëm të  
Policisë**

7

**Përmbledhje ekzekutive**

9

**Siguria, rendi dhe qetësia publike**

11

**Siguria në trafikun rrugor**

13

**Policimi në bashkësi**

14

**Parandalimi dhe luftimi i krimit të  
organizuar, krimeve të rënda, krimit  
ekonomik dhe korrupsionit,  
terrorizmit, ekstremizmit të  
dhunshëm dhe radikalizmit**

17

**Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe  
materiale**

## LISTA E SHKURTESAVE

BIMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Kufijve
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DShSh	Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
KA	Komisioni i Ankesave
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PK	Policia e Kosovës
PRIMS	Sistemi informativ i Menaxhimit të Resurseve të Policisë së Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QKTGj	Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut
QS	Qendra Studentore
SIPK	Sistemi i Integruar Informativ i Policisë së Kosovës
UD	Ushtruesi i detyrës
UO	Urdhër Operativ



## Z. FEHMI HOTI

Ushtrues i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm  
të Policisë së Republikës së Kosovës

### Mesazhi i Ushtruesit të detyrës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

Kam kënaqësinë të paraqes raportin vjetor të punës së Policisë së Kosovës për vitin 2022, në të cilin janë paraqitur arritjet tona në realizimin e synimeve, objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara. Në këtë rast rezultatet dhe të arriturat e punës sonë flasin për përkushtimin e të gjithë personelit policor për t'u përballur me sfidat gjatë kësaj periudhe kohore.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë arritjet e Policisë në ballafaqimin me sfidat duke përdorur në mënyrë efikase kapacitetet tona si në aspektin e Burimeve njerëzore ashtu edhe resurset tjera materiale, logjistike, teknike dhe teknologjike. Krahas punës operative fokusi jonë ka qenë edhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve tona në të gjitha fushat, prandaj ky raport përmban dy pasqyra të rëndësishme, atë të arritjeve në fushën e zbatimit të ligjit dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve tona për të ardhmen.

Edhe gjatë vitit të kaluar ne kemi pasur objektivat kryesore realizimin e aktiviteteve që ndikojnë në zbatimin e ligjit në mënyrë efikase dhe efektive, parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, mbikëqyrjen dhe kontrollin efikas të kufirit shtetëror si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Të gjitha aktivitetet tona janë drejtuar nga metodologjia e punës sonë, e drejtuar nga koncepti i policimit të drejtuar me inteligjencë dhe në komunitet.

Fatkeqësisht edhe këtë vit jemi përballuar me situata të rënda në fushën e mbajtjes së rendit dhe sigurisë publike në veri me aktivitete, të cilat kanë pasur për qëllim pengimin e zbatimit të ligjit në mënyrë të drejtë dhe barabartë për të gjithë qytetarët. Policia e Kosovës, me përkrahjen edhe të institucioneve tjera shtetërore por edhe të qytetarëve, ka arritur të menaxhojë situatën me maturi dhe profesionalizëm. Gjatë kësaj periudhe aktivitetet policore kanë pasur fokus rendin dhe ligjin në komunat veriore të Kosovës, ku kemi pasur bllokim të rrugëve përmes barrikadave, aktiviteteve penguese ndaj zyrtarëve policorë por edhe aktivitetet tjera kriminale. Falë angazhimit tonë është shtuar aktiviteti policor në parandalimin dhe luftimin e krimit, kontrabandës dhe aktivitete tjera të jashtëligjshme. Janë mbyllur rrugët ilegale të cilat janë shfrytëzuar nga struktura kriminale për aktivitete të kontrabandës ndërkuftare. Në atë zonë ne kemi rritur edhe kapacitetet tona si në infrastrukturë por edhe në kapacitet të burimeve njerëzore.

Fatkeqësisht edhe viti 2022 ka qenë vit i ndikuar, ndonëse në masë më të vogël nga ndikimi i pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID -19, duke u përballur me vështirësitë që ka sjellë kjo situatë për tërë shoqërinë dhe institucionet e vendit, përfshirë edhe vetë organizatën tonë, ku përveç që

kemi qenë të angazhuar me detyra shtesë, personeli ynë ka qenë i atakuar gjithashtu nga virusi.

Në këtë raport vjetor ne shohim të arriturat tona, rezultatet, sfidat, nevojat dhe planifikimet që duhet bërë për avancimin dhe shtimin e aktiviteteve në fusha të caktuara, në arritjen e synimeve dhe objektivave tona, me qëllim të ngritjes së performancës së Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti falë punës në aspektin e parandalimit dhe luftimit të dukurive negative, kemi disa rezultate pozitive, siç janë ulja e numrit të vrasjeve, veprave penale të grabitjeve, veprave penale të vjedhjeve etj., ndërsa që është rritur numri i rasteve të dhunës në familje.

Ndonëse gjatë vitit që lamë pas kemi pasur rezultate të mira akoma mbetet sfida siguria në trafikun rrugor, ku Policia e Kosovës ka qenë e angazhuar në vazhdimësi me veprime proaktive dhe reaktive, fushata sensibilizuese, bashkëpunime me institucione relevante dhe akterë të tjerë. Duke qenë të vetëdijshëm se siguria në trafikun rrugor, si dhe organizimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të rregullt dhe funksional të komunikacionit rrugor kërkon një qasje multi-disiplinare, ne jemi angazhuar sipas kompetencave dhe autorizimeve që kemi duke kërkuar edhe nga institucionet e tjera bashkëpunimin e plotë.

Për këtë vit vlen të përmendet vazhdimi i aktiviteteve policore në parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda në përgjithësi dhe në veçanti krimin të organizuar, krimin ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Në këtë fushë janë realizuar 347 operacione policore, ku janë arrestuar 1516 persona dhe janë ngritur 1094 kallëzime penale si dhe janë goditur 34 grupe kriminale.

Sa i përket fushës së Policisë Kufitare, është treguar një përkushtim i veçantë në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, luftimin e kontrabandës, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimin ndërkufitar, si dhe avancimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Gjatë vitit kemi pasur një rritje të konsiderueshme të qarkullimit ndërkufitar.

Gjatë vitit 2022 gjithashtu kemi qenë të përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, trajnimin e personelit dhe zhvillimin e vazhdueshëm përmes programeve adekuate profesionale.

Në këtë vit, radhëve të Policisë së Kosovës i është shtuar gjenerata e 57-të, ndërsa jemi në proces të rekrutimit për kandidatë të rinj për policë, që kësaj radhe për herë të parë, aplikimi i kandidatëve është realizuar online, me çka është lehtësuar aplikimi për vetë aplikantët, si dhe është lehtësuar edhe puna e personelit policor të kyçur në proces. Vlen të theksohet se po ashtu edhe testimi me shkrim është në përgatitje e sipër të zhvillohet online.

Gjatë vitit që lëmë pas kemi pasur edhe rritjen e numrit të dorëheqjeve nga Policia e Kosovës në veçanti nga pjesëtarët e komunitetit serb në stacionet policore në komunat e veriut të Kosovës. Ne jemi angazhuar maksimalisht për të plotësuar vakumin e shkaktuar nga këto dorëheqje përmes angazhimit shtesë të personelit policor me qëllim të kryerjes së detyrave dhe aktiviteteve por edhe ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët.

Krahas të gjitha të arriturave, rezultateve dhe sfidave që kemi para nesh, dua të shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tim, si dhe mbështetjen e pa rezervë për punën e palodhshme të pjesëtarëve të Policisë, të cilët janë duke dhënë kontributin e tyre të vazhdueshëm në rrugëtimin tonë të përbashkët.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 8,699 punonjës, prej të cilëve 7,816 janë zyrtarë policorë, ndërsa 883 staf civil. 85.24% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 14.76% gjinisë femërore, prej të cilëve 91% janë shqiptarë, ndërsa 9% iu takojnë komuniteteve të tjera.

- Numri i vrasjeve ka shënuar rënie për 22.22%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie për 12.5%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, për 13.06%;
- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar rënie, për 41.13%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, për 17.54%.

Me qëllim të adresimit të qëndrueshëm të sfidave në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka arritur dukshëm të modernizojë pajisjet e saj dhe tani njësitet përkatëse të trafikut rrugor janë në posedim të pajisjeve me teknologji bashkëkohore.

Me qëllim që të identifkohen, adresohen dhe të parandalohen sëmundjet dhe dukuritë tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, gjatë kësaj periudhe ekipi mjekësor dhe Ekipi për Këshillim dhe Përkrahje i PK-së kanë mbajtur: 321 seanca psikologjike, 674 testime dhe 78 rivlerësime. Gjithsej përkrahje mjekësore është ofruar për 9,277 pjesëtarë të Policisë. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Policisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për ekzaminimin mjekësor sistematik të personelit policor, gjatë kësaj periudhe janë ekzaminuar 513 zyrtarë policorë të grupmoshës 50-59 vjeçare, ndërkaq janë realizuar 48 ekzaminime mjekësore dhe psikologjike në SHSKUK për verifikimin e aftësisë së punës si dhe 139 ekzaminime mjekësore të avancuara (rezonancë magnetike).

Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,725 raste. Janë:

- realizuar 347 operacione;
- arrestuar 1,516 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, ndërsa janë ndaluar 647 persona;
- bastisur&kontrolluar 813 lokale;
- paraqitur 1,094 kallëzime penale, 55 prej të cilave me kryes të panjohur, 1,034 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 2,030 personave; si dhe janë
- goditur 34 grupe kriminale.

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi dhe në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit të drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2021-2025, Policia ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me komunitetin nëpërmes një numri të madh projektesh dhe një sërë aktiviteteve. Gjatë kësaj periudhe është promovuar projekti “Njihuni me policin tuaj” në dy Drejtori Rajonale (Prishtinë dhe Mitrovicë Veriu), me ç’rast u janë shpërndarë kartelat policëve në sektorë së bashku me posterët e dedikuar për këtë projekt. Me implementimin e këtij projekti synohet rritja e mëtejme e bashkëpunimit dhe partneritetit me qytetarë, duke iu dhënë mundësi qytetarëve të njohin policin e lagjes së tyre. Ky projekt do të vazhdojë së implementuari në të gjitha rajonet dhe stacionet policore, me ç’rast do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e bashkëpunimit të drejtë me qytetarët dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në vend.

Gjatë kësaj periudhe është hapur konkursi për polic, me ç’rast janë zhvilluar të gjitha procedurat. Gjenerata e 57-të e Policisë po vazhdon trajnimin në AKSP me 434 kandidatë, ndërsa është bërë informimi i kandidatëve për testimin psikologjik-mjekësor për gjeneratën e 58-të. Policia ka arritur të organizojë dhe të administrojë gjithsej 1,187 trajnime për zyrtarë të saj.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 75 operacione, 808 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 94 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, 7,261 refuzime të hyrjes dhe 708 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës. Janë shqiptuar 1,311 gjoba në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit.

Policia e Kosovës është vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 1,219 komunikata, janë publikuar 1,941 aktivitete policore, 365 raporte 24-orësh; revista e Policisë “Mbrotjësi”.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Raste	
Viti 2021	Viti 2022
50,148	49,183



Vepra penale	
Viti 2021	Viti 2022
30,108	29,857



Persona të arrestuar	
Viti 2021	Viti 2022
15,248	16,124



Persona të ndaluar	
Viti 2021	Viti 2022
5,540	5,630



Grupe kriminale të goditura	
Viti 2021	Viti 2022
49	34



Armë zjarri të konfiskuara	
Viti 2021	Viti 2022
1,280	1,473



Municione të konfiskuara	
Viti 2021	Viti 2022
42,031	29,903



Persona të vdekur në trafikun rrugor	
Viti 2021	Viti 2022
111	106



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor	
Viti 2021	Viti 2022
484,138	646,790



Gjoha për kundërvajtje në fushën e migrimit	
Viti 2021	Viti 2022
1,213	1,311



Aksidente në trafikun rrugor	
Viti 2021	Viti 2022
21,275	20,792



Hyrje/dalje të personave në kufi	
Viti 2021	Viti 2022
20,079,046	23,264,201



Protesta dhe tubime të qytetarëve	
Viti 2021	Viti 2022
271	196



Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës	
Viti 2021	Viti 2022
7,436	7,261



Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës	
Viti 2021	Viti 2022
635	708



## SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, Policia e Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjes së objektivave policore.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 49,183 raste, prej të cilave 29,857 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 19,326 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, numri i rasteve ka shënuar rënie për 1.92%, numri i veprave penale ka shënuar rënie për 0.83% dhe numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera, po ashtu kanë shënuar rënie për 3.56%. Rënie/ngritje më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar rënie, nga 27 në 21 ose rënie për 22.22%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie, nga 296 në 259, ose rënie për 12.5%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar rënie, nga 4,333, në 4,094, ose rënie për 5.51%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 3,223 në 2,802, ose rënie për 13.06%;



- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar rënie, nga 158 në 93, ose rënie për 41.13%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar ngritje, nga 2,456 në 2,757, ose ngritje për 12.25%.

Policia e Kosovës ka ndaluar 5,630 persona, për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 është shënuar një ngritje për 1.62%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 16,124 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e personave të arrestuar për 4.51%.



Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 1,473 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 është shënuar një ngritje për 15.07%, si dhe janë konfiskuar 29,903 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 është shënuar një rënie për 28.85%.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 196 protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 vërehet një rënie e protestave dhe tubimeve për 27.67%.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2022, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteve tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç' rast janë ofruar 7,345 asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një rënie e ofrimit të asistencës për 19.40%.



Policia ka vazhduar të ofrojë siguri 24 orëshe në 158 pika statike të objekteve të rëndësishme të veçantë: diplomatike, qeveritare, policore, ministrotore si dhe objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa për të gjitha objektet tjera të rëndësishme të veçantë, Policia e Kosovës kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, ku në bazë të vlerësimeve ndërmerr edhe aktivitete tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.

Në veçanti në vitin 2022, për shkak të aktiviteteve të grupeve kriminale në pjesën e veriut të Kosovës, të cilët gjithashtu kanë pasur tendencë destabilizimin e situatës së sigurisë në atë pjesë, Policia e Kosovës ka ndërmarrë një mori aktivitete policore, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit, si dhe ofrimit të sigurisë së qëndrueshme, kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, policia ka zbatuar urdhrat operativ, planet operative, operacionet, në të cilat janë angazhuar operacionalisht numër i madh i zyrtarëve policorë. Gjatë zbatimit të këtyre aktiviteteve policore, nga grupet e ndryshme kriminale, njësitet policore janë sulmuar, në të cilat aktivitete të jashtëligjshme kemi pasur edhe lëndime dhe zyrtarë policorë të plagosur.




## SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shtetet e tjera. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të ngrihet siguria në trafikun rrugor, duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në bërthamën e saj ka: i) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, (i.i.) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësisë organizative të Policisë, pastaj ato ndërinstitucionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor dhe (i.i.i.) orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Me qëllim të adresimit të qëndrueshëm të sfidave në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka arritur dukshëm të modernizojë pajisjet e saj dhe tani njësitet përkatëse të trafikut rrugor janë në posedim të pajisjeve me teknologji bashkëkohore, e cila përfshin: kamera në trup; vetura të reja me kompjuterë të cilët kanë qasjen në bazën e integruar të të dhënave të policisë; radar dore për matje të shpejtësisë së mjeteve motorike të cilët mundësojnë ofrimin e dëshmive për kundërvajtje në trafikun rrugor.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e investimit të vazhdueshëm për të avancuar qasjen bashkëkohore e ofrimit të sigurisë në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka filluar një projekt të ri: Patrulla



inteligjente “Smart Patrol”, i cili është në fazën fillestare të implementimit.

Përmes këtyre pajisjeve inteligjente mundësohen veprime si në vijim:

- menaxhimi i mençur i trafikut;
- identifikimi i shpejtësisë në lëvizje dhe statik në të dy drejtimet, 24h ditën dhe natën;
- identifikimi dhe dëshmimi me fotografi dhe video i të gjitha llojeve të kundërvajtjeve në trafik;
- mundëson shqiptimin e gjobave digjitale/automatike dhe dërgimin e tyre në adresën e pronarit të mjetit;
- identifikimi i mjeteve të regjistruara, mjeteve të paregjistruara, mjete të vjedhura, targa të vjedhura apo përdorimi i targave që nuk i përkojnë mjetit që i mban;
- mundëson identifikimin e personave dhe mjeteve në kërkim;
- identifikimi i të gjitha kundërvajtjeve, duke përfshirë kohën e ndalimit të drejtimit të mjeteve motorike dhe pikët negative;
- mundëson menaxhimin e parkimit të veturave të ndaluara dhe parkuara në vende të palejuara,
- monitorimin 360 shkallë dhe me sistemin ditën dhe natën.





Për të adresuar sfidat në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka hartuar dhe ka zbatuar 17 plane operative në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor. Janë hartuar 139 raporte analitike dhe janë realizuar inspektime të infrastrukturës rrugore, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve. Ka hartuar 223 raporte/shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar tek institucionet përkatëse. Janë realizuar 79 takime dhe pjesëmarrje në 11 emisione radio/televizive dhe 109 fushata vetëdijesuese, të fokusuar në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Në kuadër të angazhimit të Policisë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë vitit 2022 Policia ka shqiptuar 646,790 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që në raport me vitin 2021 është shënuar ngritje për 33.59%.

#### **Gjatë kësaj periudhe është vërejtur rënie e disa kategorive të aksidenteve në trafikun rrugor:**

- aksidenteve në trafikun rrugor, nga 21,275 në 20,792 aksidente, apo rënie për 2.27%;
- aksidenteve me fatalitet, nga 99 në 95 aksidente, apo rënie për 4.04%;
- aksidenteve me lëndime, nga 7,651 në 7,755 aksidente, apo ngritje për 1.35%;
- aksidenteve me dëme materiale, nga 13,525 në 12,941 aksidente, apo rënie për 4.31%.
- 106 persona kanë humbur jetën, që në raport me



periudhën e njëjtë të vitit 2021 shënon rënie për 4.50%,

- 14,726 persona janë lënduar, që në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 shënon ngritje për 0.71%.

Sa iu përket aktiviteteve të Komisionit për Vendosje, lidhur me kundërshtime të parashtruara për kundërvajtjet e shqiptuara nga ana e Policisë, gjatë këtij muaji janë pranuar gjithsej 5,218 kundërshtime (ankesa), janë mbajtur gjithsej 496 seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe janë përpiluar gjithsej 5,882 vendime.

Në kuadër të angazhimeve në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 360 përcjellje të materieve të rrezikshme dhe 9 përcjellje të personaliteteve të rëndësishme dhe 496 përcjellje në përputhje me UO për gatishmëri dhe reagim kundër virusit COVID-19.

# POLICIMI NË BASHKËSI

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi dhe në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit të drejtuar nga Inteligenca dhe Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2021-2025, Policia e Kosovës ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me komunitetin nëpërmes një numri të madh projektesh dhe një sërë aktiviteteesh.



Këto aktivitete kanë qenë të drejtuara në parandalimin e krimit dhe realizimin e projekteve në vetëdijesimin dhe këshillimin e nxënësve në fusha të ndryshme të dukurive negative në shoqëri. Avancimi i Strategjisë së Integruar të Policimit të drejtuar nga Inteligenca dhe Policimit në Bashkësi dhe realizimi

i aktiviteteve të parapara në këtë strategji, ka qenë ndër prioritetet e Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, e në fokus të veçantë aktivitetet që



parashihen në objektivin “Për besueshmërinë dhe kënaqshmërinë e publikut me shërbimet e Policisë”. Gjatë kësaj periudhe është promovuar projekti “Njihuni me policin tuaj” në dy Drejtori Rajonale (DRP Prishtinë dhe DRP Mitrovicë Veriu), me ç’rast iu janë shpërndarë kartelat policëve në sektorë së bashku me posterët e dedikuar për këtë projekt. Me implementimin e këtij projekti synohet rritja e mëtejme e bashkëpunimit dhe partneritetit me qytetarë, duke iu dhënë mundësi qytetarëve të njohin policin e lagjes së tyre. Ky projekt do të vazhdojë së implementuari në të gjitha rajonet dhe stacionet policore, me ç’rast do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e bashkëpunimit të drejtë me qytetarët dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në vend.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë komunale të arsimit dhe menaxhmentin e shkollave, në institucionet e arsimit para-universitar të Republikës së Kosovës Policia ka organizuar aktivitete parandaluese dhe ligjërata vetëdijesuese për nxënës në temat si: parandalimi i përdorimit të substancave narkotike, dhunën në familje, ngacmimet në shkolla, parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmi të dhunshëm dhe dhuna në baza gjinore etj. Përveç ligjëratave në shkolla, Policia ka realizuar edhe një sërë projektesh me fëmijë si: “Të festojmë së bashku të ardhmen tonë-1 Qershori”, “Festojmë së bashku 2023”, Të kujdesemi për sigurinë”, “Së bashku për shkolla të sigurta”, “Puna vullnetare e të rinjve në PK” etj.



## PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA, KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Policisë së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e krimit, në theks të veçantë të krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik & korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, Policia në vazhdimësi harton analiza të ndryshme, duke përfshirë edhe vlerësimin e kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimit të organizuar – SOCTA, i cili përmban: (a) vlerësimin e detajuar lidhur me format më të theksuara të krimit të organizuar dhe atyre serioze; pastaj (b) kërcënimet që paraqesin këto forma të kriminalitetit, duke potencuar kërcënimet e përgjithshme të sigurisë, ekonomisë, shoqërisë por edhe individëve në veçanti, si dhe (c) sfidat dhe vështirësitë e identifikuar, për të cilat janë dhënë rekomandime konkrete për zvogëlimin apo eliminimin në tërësi të tyre.

Si rezultat i këtyre analizave, gjatë kësaj periudhe raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,725 raste, prej tyre 1,041 raste të reja, 449 raste të pranuar nga njësitë e tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, 235 raste janë bartur nga vitet paraprake. Sa i përket krahasimit të numrit të rasteve në punë

me vitin 2021 tregon ngritje për 6.94%;

Janë realizuar 347 operacione, që krahasuar me vitin 2021 tregon rënie për 39.22% dhe janë bastisur dhe janë kontrolluar 813 lokale, që në krahasim me vitin 2021 tregon rënie për 24.16%;

Gjatë vitit 2022 janë arrestuar 1,516 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, që krahasuar me vitin 2021 tregon ngritje për 11.47%, ndërsa janë ndaluar 647 persona, që krahasuar me vitin 2021 tregon rënie për 11.61%.

Janë paraqitur 1,094 kallëzime penale, 55 prej të cilave me kryes të panjohur, 1,034 kallëzime penale me kryes të njohur ndaj 2,030 personave që krahasuar me vitin 2021 kemi një ngritje të kallëzimeve penale për 0.27%. Janë goditur 34 grupe kriminale që krahasuar me vitin 2021 tregon rënie për 30.61%.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë vitit 2022 janë regjistruar 140 raste, janë arrestuar 254 persona të dyshuar dhe janë paraqitur 86 kallëzime penale ndaj 158 personave të dyshuar dhe 49 fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj 122 personave. Prej tyre, për: a) trafikim me njerëz - janë regjistruar 20 raste; b) mundësim prostitucioni - janë iniciuar 26 raste; c) marrje me prostitucion - janë regjistruar 49 raste dhe d) për krim të organizuar





është regjistruar 1 rast; e) për vepra të tjera të kësaj natyre - janë regjistruar 44 raste. Janë identifikuar 22 viktima të trafikimit, 12 viktima të supozuara të trafikimit dhe 59 viktima të veprave tjera. Janë asistuar 49 viktima dhe janë strehuar 15 viktima të trafikimit.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë iniciuar gjithsej 808 raste të reja, janë arrestuar 1,039 persona dhe janë paraqitur 532 kallëzime penale ndaj 791 të dyshuarve. Prej tyre, për: a) trafikim- janë regjistruar 271 raste, b) posedim të drogave - 505 raste, c) kultivim 32 raste. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar 30 raste për kokainë janë regjistruar 45 raste, për marihuanë janë iniciuar 658 raste, për kultivimin e bimëve të kanabisit janë iniciuar 32 raste ndërsa për droga të tjera janë regjistruar 10 raste.

Gjatë vitit 2022 janë konfiskuar 246 kg. 665.56 gr. heroinë; 4 kg 165.18 gr. kokainë; 662 kg 669.69 gr. marihuanë, 24,511 bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit janë regjistruar 318 raste, janë arrestuar 81 të dyshuar dhe janë paraqitur 313 kallëzime penale ndaj 586 personave të dyshuar. Për veprën penale: a) kundër detyrës zyrtare/korrupsionit- janë regjistruar 172 raste; b) kundër ekonomisë - 49 raste; c) kundër pasurisë- 33 raste; d) falsifikim dhe mashtrim - 46 raste; e) shpëlarje të parave- 8 raste; dhe e) vepra të tjera janë regjistruar 10 raste.

Në fushën e hetimit të krimeve të rënda, gjatë kësaj

periudhe janë regjistruar 102 raste. Janë arrestuar 43 persona të dyshuar dhe janë paraqitur gjithsej 59 kallëzime penale ndaj 336 persona të dyshuar.

Spektori për hetimin e krimeve të luftës ka iniciuar 26 raste, ka arrestuar 5 persona dhe ka përcjellë 16 kallëzime penale ndaj 146 personave.

Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda për periudhën kohore janar-dhjetor 2022, ka trajtuar 20 raste për veprat penale ndaj gazetarëve, prej tyre 6 janë nën hetime, të tjerat i janë referuar prokurorive kompetente (9 raste me kallëzim penal ndaj 11 personave të dyshuar, 1 kallëzim penal kundër NN dhe 4 me raporte të veçanta).

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit- janë regjistruar 37 raste, janë arrestuar 7 persona të dyshuar dhe janë paraqitur 3 kallëzime penale ndaj 6 personave të dyshuar. Prej gjithsej 37 rasteve 11 janë regjistruar në fushën e terrorizmit dhe 26 për vepra tjera (incidentet në veri).

Në fushën e hetimit të krimit të organizuar, gjatë kësaj periudhe janë iniciuar 82 raste, janë arrestuar 92 persona të dyshuar dhe janë ngritur 39 kallëzime penal ndaj 123 të dyshuarve. Po ashtu janë trajtuar edhe 70 raste me hetime preliminare. Për veprën penale: a) krim i organizuar- janë regjistruar 2 raste; b) trafikim me armë - 5 raste; c) trafikim me migrantë- 2 raste; d) fajde - 6 raste; e) krime kibernetike- 54 raste; f) auto krime- 8 raste dhe g) për vepra tjera të kësaj natyre janë regjistruar 5 raste.

## KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Policia e Kosovës ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK). Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve, autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 23,264,201 persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregojnë ngritje për 15.86%; 7,565,514 mjete motorike, që tregojnë ngritje për 6.49% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa rënie për 100% e trenave.

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar 6,365 persona të rëndësishëm.

Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë:

Tabela nr. 1: Kontrolli i vijës së dytë.

Kategoritë	Viti 2021	Viti 2022	%
Persona	53,451	47,161	-11.76
Automjete	39,718	35,912	-9.58
Dokumente	14,716	15,418	4.77



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkëlqeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 756 raste të veprave penale, 301 kundërvajtje, kanë shqiptuar 1,311 gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar: a) 814 persona për vepra të ndryshme kriminale; b) 1,535 persona me urdhëresa vendore; c) 2 persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe ka ndaluar 137 persona.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 919 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 7,261 refuzime të hyrjes, 708 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 1,409 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 20 depërtime, 40 urdhër largime me forcë, 110 urdhër largime vullnetare dhe kanë trajtuar 547 kërkesa për azilkërkues.

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar 75 operacione dhe 908 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 91 takime të punës brenda Policisë, 79 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 94 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës ka qenë po ashtu e angazhuar në zbatimin e vendimit të ministrit të MPB-së nr.: 0612/2021, lidhur me masat reciproke për targa të Republikës së Serbisë, ku obligohet pajisja me targa të përkohshme të RKS-së, për të gjitha automjetet që mbajnë targa të Republikës së Serbisë që hyjnë në territor të Republikës së Kosovës.



## NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE

Policia e Kosovës përbëhet nga 8,699 punonjës, prej të cilëve 7,816 janë zyrtarë policorë, ndërsa 883 staf civil. Nga ky numër 85.24% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 14.76% gjinisë femërore, prej të cilëve 91% janë shqiptarë, ndërsa 9% iu takojnë komuniteteve tjera.

Gjatë kësaj periudhe dorëheqje nga Policia kanë dhënë gjithsej 646 punonjës, nga ta 595 zyrtarë policor (573 zyrtarë në veri të vendit) dhe 51 staf civil.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të saj, Policia e Kosovës në vazhdimësi investon në kuadrat e saj, duke filluar me rekrutimin e gjeneratave të reja të policëve, ofrimin e njohurive bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e sistemeve të bazës së të dhënave, të nevojshme për kryerjen sa më efektive dhe efikase të punës policore, furnizimin me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave policore, renovimin/sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës së objekteve të Policisë, si dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së zyrtarëve të saj.

Gjatë këtij viti është hapur konkursi për policë me ç'rast janë zhvilluar të gjitha procedurat dhe gjenerata e 57-të e Policisë po vazhdon trajnimin në AKSP me 435 kandidatë, ndërsa është bërë informimi i kandidatëve për testimin psikologjik-mjekësor për gjeneratën e 58-të.

Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë ndarë: 1,002 medalje për shërbim të besnikërisë, 4 medalje mburojë e Policisë, 5 medalje për shërbim



të dalluar, 26 medalje për lëvdim, 104 lëvddata dhe 162 mirënjohje nga drejtori i përgjithshëm.

Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë ndarë: 1,002 medalje për 'Shërbim të Besnikërisë', 4 medalje 'Mburojë e Policisë', 5 medalje për 'Shërbim të dalluar', 26 medalje për 'Lëvdim', 104 lëvddata dhe 162 mirënjohje nga drejtori i përgjithshëm.

Një nga drejtimet e rëndësishme për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të Policisë ka qenë dhe mbetet prioritet trajnimi dhe shkollimi i punonjësve të Policisë përmes trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara, duke i organizuar brenda dhe jashtë vendit.



Gjatë kësaj periudhe, përkundër angazhimeve të mëdha operacionale, Policia ka arritur të organizojë dhe të administrojë gjithsej 1,187 trajnime, që krahasuar me vitin 2021 tregojnë rritje për 20.86%. Nga Divizioni i Trajnimeve janë realizuar: 170 trajnime për 3,347 pjesëtarë të saj dhe 190 ricertifikime për 2,313 zyrtarë policorë. Në bashkëpunim me organizatat të tjera janë organizuar 508 trajnime për 4,617 pjesëtarë të saj. Ndërsa, jashtë vendit janë organizuar 1,312 aktivitete (trajnime, takime, konferenca) për 815 zyrtarë policorë. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Trajnimeve ka organizuar 7 trajnime për organizatat tjera, në të cilat kanë marrë pjesë 711 pjesëmarrës. Bazuar në nevojat për rifreskimin e trajnimeve, Divizioni i Trajnimeve ka rifreskuar 26 planprograme.

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2022, ka në dispozicion buxhetin prej 120,105,688.31€. Për paga të punonjësve të Policisë janë shfrytëzuar shuma prej 81,107,051.00€, ndërsa shuma e përgjithshme e të hyrave për këtë periudhë kohore ka qenë 17,716,809.01€. Brenda kësaj periudhe janë iniciuar 223 projekte të prokurimit, prej të cilëve 162 kanë qenë për furnizim, 34 për shërbim, ndërsa 27 për punë.

Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia e Kosovës monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar 1,020 lëndë disiplinore, prej tyre 598 lëndë të hapura gjatë vitit 2022 dhe



422 lëndë të bartura nga vitet paraprake. Nga gjithsej 422 lëndë të bartura janë përfunduar 212 lëndë apo 50.23% e tyre.

Nga gjithsej 698 lëndë të përfunduara, 279 lëndë kanë qenë me status të bazuar, 388 me status të paargumentuar dhe për 31 lëndë kanë pushuar hetimet.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar 276 lëndë dhe janë shqyrtuar 293 lëndë. Janë nxjerrë 531 vendime disiplinore, nga të cilat: 52 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; 162 raste ndalesë në pagë mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj; 2 transfere; 28 raste ndalesë në pagë 5% deri në 20% të pagës mujore bruto deri në dy muaj; 103 vërejtje me shkrim; 23 vërejtje me gojë; 13 raste është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe lirohet nga shqiptimi i masës disiplinore.

Komisioni i Ankesave ka pranuar 516 ankesa, ndërsa ka shqyrtuar 505 ankesa, prej të cilave: në 340 raste është konstatuar se ankesa ka qenë e pabazuar dhe vendimi mbetet në fuqi; në 70 raste ankesa ka qenë e bazuar dhe e aprovuar; në 65 raste ankesa ka qenë pjesërisht e bazuar dhe vendimi ka qenë pjesërisht i ndryshuar; në 17 raste vendimi është kthyer në plotësim të hetimeve, ndërsa në 13 raste ankesa është hedhur poshtë sepse është parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesi, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme. Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i kësaj kontrole, gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar





10 auditime të rregullta, për të cilat janë dhënë 15 rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë.

Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar 45 inspektime të rregullta si dhe 41 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 141 rekomandime.

Shëndeti i personelit policor është në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, adresohen dhe parandalohen sëmundjet dhe dukuritë tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, gjatë kësaj periudhe ekipi mjekësor dhe Ekipi për Këshillim dhe Përkrahje i DShSh-së kanë mbajtur: 321 seanca psikologjike, 674 testime dhe 78 rivlerësime. Gjithsej përkrahje mjekësore është ofruar për 9,277 pjesëtarë të Policisë.



Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Policisë dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për ekzaminimin mjekësor sistematik të personelit policor, gjatë kësaj periudhe janë ekzaminuar 513 zyrtarë policorë të grupmoshës 50-59 vjeçare, ndërkaq janë realizuar 48 ekzaminime mjekësore dhe psikologjike në SHSKUK për verifikimin e aftësisë së punës si dhe 139 ekzaminime mjekësore të avancuara (MRI-Rezonancë Magnetike). Është realizuar testimi psikologjik për 522 kandidatë dhe kontrollimi mjekësor për 520 kandidatë (në baza ditore nga 35 kandidatë) i rekrutëve të rinj, sipas standardeve mjekësore për aplikuesit e Policisë së Kosovës.

Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore në bashkëpunim me QKTGJ, ka realizuar Aksionin Humanitar “Dhurimi vullnetar i gjakut”, me ç’rast ka pasur 1,354 dhurues vullnetarë.

Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit të modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me planin Strategjik të Zhvillimit për 2016-2022. Në kuadër të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara në ofrimin e qëndrueshmërisë: a) Sistemi i Integruar Informativ i Policisë (SIPK); b) Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS); c) Sistemi i Menaxhimit të Kufijve (BIMS); d) Sistemi i vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore; e) POTS - Police Online Tracking System; f) Rritja e kapacitetit të rrjetit mikrovalor; g) Digjitalizimi i radio komunikimit.



Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën e sigurisë rrugore, armëmbajtjes pa leje, përdorimit të dhunës etj. Gjatë periudhës raportuese në nivel qendror dhe lokal të Policisë:

- a) janë lëshuar 1,219 komunikata me shkrim për media;
- b) janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;
- c) janë publikuar 1,941 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;
- d) janë dizajnuar dhe janë publikuar 151 projekte policore;
- e) është hartuar dhe është publikuar revista e Policisë së Kosovës ‘MBROJTËSI’ dhe
- f) janë publikuar spote televizive, broshura vetëdijesuese lidhur me parandalimin e veprave penale si dhe aksidentet në trafik si çështje me rëndësi në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

Duke marrë në konsideratë faktin se Policia e Kosovës udhëhiqet nga parimi i policimit demokratik dhe si rrjedhojë e kësaj transparencë para shoqërisë dhe publikut në përgjithësi është esenciale për funksionimin e Policisë, gjatë këtij viti faja zyrtare e Policisë së Kosovës në rrjetin social ‘Facebook’ <https://facebook.com/Kosovopolic/> ka pasur gjithsej 151 mijë ndjekës aktivë, një rritje për 20% krahasuar me vitin e kaluar.

Ndër më të shikuarat në faqen zyrtare të Policisë së Kosovës në Facebook dhe Twitter, kanë qenë postimet që kanë të bëjnë me shërbimin ndaj qytetarëve, që ndërlidhen me sigurinë rrugore, publikime të ndryshme të natyrave të ndryshme për vitin 2022. Duke u bazuar në numrin e shikueshmërisë del se lajmi i datës 28 tetor 2022 “Kërkohet personi i dyshuar i cili shihet në video-incizim dhe foto” ka shënuar numrin prej 232,2 mijë shikimeve. Sa iu përket publikimeve në Facebook, gjatë vitit 2022, kemi pasur 2,2 milionë shikime në total, ndërsa faja zyrtare e Policisë në Facebook është renditur e para për nga shikimet, gjithashtu është e pëlqyer me mbi 89.4K në këtë vit, krahasuar me vitin paraprak i cili ka qenë rreth 65.1 K.





**POLICIA E KOSOVËS**  
**POLICIJA KOSOVA**  
**KOSOVO POLICE**

# PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL APLIKACIONI ‘LAJMËRO POLICINË’

MUNDËSI AL-  
TERNATIVE E  
KOMUNIKIMIT TË  
QYTETARIT ME  
POLICINË PËR  
LAJMËRIMIN E  
RASTEVE

GARANTIM  
ANONIMITETI  
DHE REAGIM  
I SHPEJTË

APLIKACIONI  
“LAJMËRO POLICINË”  
ËSHTË PLATFORMË  
ELEKTRONIKE

MUNDËSI  
E DËRGIMIT  
TË TEKSTEVE,  
FOTOVE  
DHE VIDEOVE

RAPORTO  
NË 24 ORË



BASHKËPUNIM,  
PARTNERITET,  
TRANSPARENCË